

VENDIM
Nr.220, datë 19.4.2006

PËR DHËNIE FONDI NDIHME, PARTISË DEMOKRATE PËR INTEGRIM E PROSPERITET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18, të ligjit nr.8580, datë 17.2.2002 “Për partitë politike”, të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë Demokrate për Integrime e Prosperitet t’i jepet një fond prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare, në çastin e krijimit.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha